

LIGJ

Nr.10 431, datë 9.6.2011

PËR MBROJTJEN E MJEDISIT¹⁰

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Neni 2

Objekti

Ky ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike; ç) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;

d) ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror; dh) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;

e) mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Neni 4

Fusha e zbatimit të ligjit

Mbrojtja e mjedisit nga ndotja e dëmtimi përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

10 Ky ligj është përafshuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 prill 2004 "Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin" të ndryshuar. Numri CELEX: 32004L0035, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 143, datë 30.4.2004, faqe 56-75.

Neni 5

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritet publik" janë:

a) organet e qeverisjes qendrore dhe vendore apo organet e tjera të administratës publike, përfshirë organizmat këshillues publikë, në nivel kombëtar, rajonal apo vendor;

b) çdo person, fizik apo juridik, që ushtron funksione administrative publike, përfshirë edhe detyra, veprimtari ose shërbime specifike që kanë të bëjnë me mjedisin;

c) çdo person, fizik apo juridik, që ka përgjegjësi a funksione publike apo që siguron shërbime publike, që kanë të bëjnë me mjedisin dhe janë nën kontrollin e një organizmi apo personi që përfshihet në grupimet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni.

2. "Cilësi e mjedisit" është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.

3. "Dëmtim i mjedisit" është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet nga njeriu ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.

4. "Kapacitet bartës" është kapaciteti i mjedisit për të pranuar ndryshimet e shkaktuara nga faktorët e jashtëm, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, vetitë e tij natyrore.

5. "Ministria" është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
6. "Ministër" është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit.
7. "Mjedis" janë përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.
8. "Mjedis i kërcënuar" është mjedisi i një zone të caktuar nën efektin e trysnisë së një ndotjeje të konsiderueshme.
9. "Ndërhyrje negative në mjedis" është çdo veprim i përkohshëm apo i vazhdueshëm i njeriut, që mund të prekë kapacitetin bartës të mjedisit apo biodiversitetin e tij, ose që ka ndikime të dëmshme mbi mjedisin.
10. "Ndotje" është futja e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhijë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit.
11. "Operator" është personi fizik apo juridik, që operon apo kontrollon instalimin, ose të cilit i është deleguar fuqi ekonomike vendimtare për funksionet teknike të instalimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
12. "Publik" është një ose më shumë persona, fizikë apo juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikave kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre.
13. "Rrezik ndaj mjedisit" është mundësia që paraqet një veprimtari njerëzore për të shkaktuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, dëmtimin e mjedisit apo për të vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e njeriut.
14. "Skema e ekomenaxhimit dhe auditimit" është një instrument menaxhimi për organizatat e biznesit dhe organizatat e tjera për të vlerësuar, për të raportuar e për të përmirësuar performancën e tyre në mjedis.
15. "Subjekt ndotës ose ndotës" është çdo person fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit.
16. "Substanca" janë elementet kimike dhe përbërjet e tyre në gjendjen e tyre natyrore apo siç prodhohen nga industria.
17. "Substancë e rrezikshme" është një substancë apo grup substancash, të cilat janë toksike, të qëndrueshme dhe me prirje për t'u akumuluar biologjikisht në mënyrë të natyrshme, si dhe substanca apo grupe të tjera substancash, të cilat paraqesin rrezikshmëri të ngjashme.

18. "Shkarkim" është lëshimi i drejtpërdrejtë apo jo i drejtpërdrejtë i substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë ose zhurmës nga burime të veçuara apo të përhapura në ajër, ujë ose tokë, si pasojë e veprimtarisë njerëzore.

19. "Veprimtari" është veprimtaria prodhuese ose operacione të instalimeve dhe impianteve të tyre.

KREU II

PARIMET E MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 6

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm

Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

Neni 7

Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake

1. Masat për mbrojtjen e mjedisit merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis.

2. Gjatë përcaktimit të masave dhe veprimtarive specifike të mbrojtjes së mjedisit zbatohet një qasje paraprake me qëllim që, në rast se ka kërcënime për dëme të rënda apo të pakthyeshme mbi mjedisin, mungesa e sigurisë shkencore të mos pengojë apo të mos shtyjë në kohë marrjen e masave efektive me kosto më të ulët, që parandalojnë dëmtimin e mjedisit.

Neni 8

Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore

1. Mbrojtja e mjedisit realizohet duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfutuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve.

2. Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve, brenda kompetencave të tyre, nxitin marrjen e masave dhe kryerjen e veprimtarive për mbrojtjen e burimeve natyrore.

Neni 9

Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit

1. Masat dhe veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit merren:

a) për të zëvendësuar ndërhyrjet që mund të sjellin efekte të dëmshme mbi mjedisin me ndërhyrje të tjera që paraqesin një rrezik apo kërcënim më të vogël apo kompensojnë efektet e dëmshme të pashmangshme;

b) për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira mjedisore, përdorimin e produkteve, të pajisjeve e të aparaturave, si dhe për zbatimin e proceseve të prodhimit, që janë më pak të dëmshme apo të padëmshme për mjedisin.

2. Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin përdorimin, për efekte të mjedisit, të teknikave më të mira të disponueshme.

Neni 10

Parimi i qasjes së integruar

1. Qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit, në tërësinë e tij.

2. Autoritetet publike, gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, cenueshmërinë e mjedisit, lidhjen ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe jo të përtëritshme, trashëgiminë kulturore dhe të pasurive materiale, tërësinë e ndërveprimeve të tyre të ndërsjella, si dhe ndërveprimin ndërmjet projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

Neni 11

Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit e miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm.

2. Republika e Shqipërisë siguron bashkëpunimin dhe solidaritetin për zgjidhjen e problemeve mjedisore globale dhe ndërqeveritare përmes marrëveshjeve ndërkombëtare e shkëmbimit të informacionit mjedisor.

3. Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre, sigurojnë mënyrën dhe kushtet e bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

Neni 12

Parimi "Ndotësi paguan"

Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar.

Neni 13

Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut

1. Çdo person ka të drejtë t'i jepet në kohë informacion për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra, në përputhje me këtë ligj, me legjislacionin të cilit ai i referohet, si dhe me ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare".

2. Gjatë zgjidhjes institucionale të problemeve të mbrojtjes së mjedisit, autoritetet publike përkatëse sigurojnë që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e të programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësit e mjedisit, si dhe në hartimin dhe miratimin e rregulloreve e të akteve me karakter të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, vendimmarrjen për dhënien e lejeve përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin, të cilit ai i referohet.

Neni 14

Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

1. Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre:

a) nxitin veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit, që parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e tij, si dhe projekte, që ulin përdorimin e substancave të caktuara, të lëndëve të para e të energjisë, apo që e ndotin më pak mjedisin;

b) mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre për masat vullnetare që ato mund të ndërmarrin, me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis.

2. Autoritetet publike, fusha e veprimit të të cilave përfshin funksione të lidhura me mbrojtjen e mjedisit, brenda kompetencave të tyre, nxitin informimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

KREU III

MBROJTJA E PËRBËRËSVE TË MJEDISIT

Neni 15

Mbrojtja e integruar

Përbërësit e mjedisit mbrohen nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre.

Neni 16

Mbrojtja e ajrit

1. Mbrojtja e ajrit përfshin masat për mbrojtjen e përbërësve dhe cilësisë së tij, me synim shmangien apo reduktimin e efekteve të dëmshme mbi shëndetin e njeriut, cilësinë e jetës dhe mjedisin në tërësi, si dhe parandalimin e pakësimit dhe ndotjes që shkakton dëmtimin e shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimatike globale.

2. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së ajrit përcaktohen në këtë ligj dhe me legjislacionin e posaçëm në fuqi.

Neni 17

Mbrojtja e ujërave

1. Mbrojtja e ujërave përfshin masat për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, në tranzicion, të ujërave bregdetare dhe të detit, në tërësi, me qëllim shmangien apo pakësimin e efekteve të dëmshme mbi ekosistemet ujore, mjedisin në tërësi, shëndetin e njeriut dhe cilësinë e jetës.

2. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së ujërave, sipas kategorive të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 18

Mbrojtja e tokës

1. Mbrojtja e tokës përfshin ruajtjen e cilësive dhe të funksioneve natyrore të tokës, parandalimin e dëmtimit të saj, monitorimin e gjendjes së tokës dhe ndryshimet në cilësinë e saj, si dhe përmirësimin dhe rehabilitimin e tokës së dëmtuar.

2. Mbrojtja e shtresës vegjetative të tokës synon mbrojtjen e aftësisë për të prodhuar, si dhe përmirësimin e rehabilitimin e saj.

3. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së tokës dhe të shtresës vegjetative të saj përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 19

Mbrojtja e natyrës

1. Mbrojtja e natyrës përfshin:

- a) ruajtjen e biodiversitetit, të ekosistemeve e të peizazhit natyror;
- b) masat për mbrojtjen e pyjeve: natyrore, pjesërisht natyrore, komplekseve pyjore dhe të tokës pyjore, rrjedhave dhe burimeve ujore, florës dhe faunës në një rajon pyjor, si dhe të stacioneve të gjeneve dhe farërave të varieteteve vendase të drurëve.

2. Masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së natyrës dhe të pyjeve përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 20

Ndryshimet klimatike

- 1. Ndryshime klimatike janë ndryshimet e shkaktuara nga ndikimet e njeriut në sistemin klimatik.
- 2. Masa të veçanta për ndryshimet klimatike përcaktohen në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.
- 3. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet akteve nënligjore, mbështet dhe nxit:
 - a) reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serë;
 - b) marrjen e masave të sigurta për kapjen dhe ruajtjen e dioksidit të karbonit;
 - c) përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe efikasitetin e përdorimit të saj.

KREU IV

MBROJTJA E MJEDISIT NË PROCESIN E PLANIFIKIMIT

Neni 21

Strategjitë dhe planet mjedisore

- 1. Ministria përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare në mënyrë periodike.
- 2. Ministria, sipas rastit, përgatit strategji dhe plane mjedisore kombëtare për secilin nga përbërësit e mjedisit.
- 3. Strategjitë dhe planet e referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave.
- 4. Këshilli i Ministrave miraton strategjitë dhe planet e referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 22

Planet vendore të veprimit për mjedisin

1. Autoritetet e qeverisjes vendore përgatitin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji.
2. Planet e veprimit, vendore, për mjedisin rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave.
3. Këshilli i autoritetit të qeverisjes vendore përkatëse miraton planet e referuara në pikën 1 të këtij neni.
4. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.

Neni 23

Planet e zhvillimit

1. Planet e zhvillimit, në kuptim të këtij ligji, përfshijnë instrumentet e parashikuara në planifikimin kombëtar, vendor e ndërvendor, dhe planifikimin e integruar, siç përcaktohet në ligjin nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit".
2. Gjatë hartimit dhe miratimit të planeve të zhvillimit, autoriteti publik përkatës mban parasysh veçanërisht ndjeshmërinë e mjedisit të një zone të caktuar, kapacitetin bartës të saj, lidhjen dhe harmoninë e vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe të papërtëritshme, trashëgiminë kulturore, si dhe tërësinë e ndërveprimeve ndërmjet zhvillimeve ekzistuese dhe atyre të planifikuara në mjedis.
3. Planet e zhvillimit përfshijnë masa për mbrojtjen e tokës, të ujërave, detit, ajrit, pyjeve, klimës, ekosistemeve, peizazhit natyror, vlerave kulturore dhe fizike, masat për menaxhimin e mbetjeve, masat për mbrojtjen kundër zhurmave, dridhjeve, erërave të pakëndshme dhe zjarrit, si dhe masa të tjera që kanë lidhje me to, që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, të përcaktuara në përputhje me këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm.

Neni 24

Vlerësimi strategjik mjedisor

1. Vlerësimi strategjik mjedisor kryhet për:
 - a) planet dhe programet në fushën e bujqësisë, pyjeve, peshkimit, energjetikës, industrisë, minierave, transportit, telekomunikacioneve, menaxhimit të mbetjeve, menaxhimit të ujërave, turizmit, planifikimit të territorit, si dhe për planet e programet e zhvillimit kombëtar, rajonal e vendor;

b) dokumentet e planifikimit strategjik, në bazë të të cilave bëhet planifikimi i zbatimit të projekteve që i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, siç përcaktohet në nenin 21 të këtij ligji;

c) planet dhe programet që mund të kenë efekt mbi zonat veçanërisht të mbrojtura, siç parashikohet në aktet ligjore të posaçme.

2. Planet dhe programet e referuara në pikën 1 të këtij neni, të cilat parashikojnë përdorimin e zonave të vogla në nivel vendor dhe/apo ndryshime jothelbësore të tyre, kërkojnë kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor vetëm në rast se ministria vlerëson se ato mund të kenë efekte të rëndësishme në mjedis.

3. Planet dhe programet, që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, por që përcaktojnë kuadrin për miratimin e zhvillimit të projekteve në të ardhmen, i nënshtrohen vlerësimit strategjik mjedisor vetëm në rast se ministria vlerëson se ato mund të kenë efekte të konsiderueshme në mjedis.

4. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin strategjik mjedisor.

Neni 25

Vlerësimi i ndikimit në mjedis

1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

2. Gjatë vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, të referuar në pikën 1 të këtij neni, duke përcaktuar efektet e mundshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujën, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të pr ojektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, përmes harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

4. Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

5. Kërkesat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen në ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

KREU V

PARANDALIMI DHE KONTROLLI I NDOTJES

SEKSIONI 1 NORMAT E MJEDISIT

Neni 26

Normat e cilësisë së mjedisit

1. Me "Normë të cilësisë së mjedisit" kuptohet kufiri i lejuar i përqendrimit të një ndotësi apo grupi të caktuar ndotësish në ajër, ujë ose tokë.
2. Normat e cilësisë së mjedisit për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish të secilit prej përbërësve të mjedisit, si dhe afatet për arritjen e normave të cilësisë së mjedisit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 27

Normat teknike të shkarkimeve në mjedis

1. Me "Normë teknike të shkarkimeve në mjedis" kuptohet masa, përqendrimi ose niveli i shkarkimit në mjedis nga një veprimtari, të cilat nuk duhet të tejkalohen gjatë një apo më shumë periudhave kohore. Normat teknike të mjedisit vendosen për grupe apo kategori të caktuara substancash.
2. Vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit për një veprimtari specifike nuk duhet të jenë më pak shtrënguese se norma teknike e shkarkimeve mjedisore përkatëse.
3. Normat teknike të shkarkimeve në mjedis, në mënyrë të përgjithshme, zbatohen në pikën ku bëhet shkarkimi nga veprimtaria.
4. Normat teknike të shkarkimeve në mjedis për ndotës apo grupe specifike ndotësish, për përbërës të veçantë të mjedisit, si dhe afatet e përkohshme për arritjen e këtyre normave përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 28

Kërkesat themelore për produktet

1. Kërkesat themelore për produktet, makineritë, pajisjet dhe teknologjitë e prodhimit, që mund të rrezikojnë apo të kërcënojnë mjedisin, parashikohen nga kuadri ligjor për sigurinë e përgjithshme të produkteve, kërkesat themelore ndaj produkteve joushqimore dhe vlerësimin e përputhshmërisë.
2. Atje ku është e nevojshme, këto kërkesa themelore përfshihen në lejen përkatëse të mjedisit, sipas seksionit 2 të këtij kreu.

SEKSIONI 2

LEJET E MJEDISIT

Neni 29

Lejet e mjedisit

1. Veprimtaritë, që shkaktojnë ndotje në mjedis, pajisen me lejen përkatëse të mjedisit, ku përcaktohen, me shkrim, kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

2. Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej tri nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut:

a) kategoria e veprimtarive A, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A;

b) kategoria e veprimtarive B, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B;

c) kategoria e veprimtarive C, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C.

Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet tri niveleve përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit.

3. Lejet e mjedisit, të përcaktuara në këtë ligj, miratohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshihen në kategorinë III. 1 të shtojcës së tij.

Neni 30

Parandalimi i aksidenteve madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme

1. Çdo veprimtari, ku substancat dhe preparatet kimike të rrezikshme janë ose mund të jenë të pranishme në sasi të tilla që mund të shkaktojnë dëm në mjedis apo në shëndetin e njeriut në rastin e një aksidenti madhor, i nënshtrohet një sistemi kontrolli për parandalimin dhe kufizimin e këtyre aksidenteve.

2. Masat për parandalimin e aksidenteve madhore, që përfshijnë substanca të rrezikshme, përcaktohen në këtë ligj dhe në ligjin për parandalimin e aksidenteve madhore, që përfshijnë substanca të rrezikshme.

Neni 31

Tavanet e shkarkimeve

1. Për qëllime të këtij neni, me "Tavan kombëtar shkarkimi" kuptohet sasia maksimale e një substance, të referuar në pikën 2 të këtij neni, e shprehur në kilotonë, e cila lejohet të shkarkohet nga territori i Republikës së Shqipërisë gjatë një viti kalendarik.

2. Republika e Shqipërisë merr masat e nevojshme për të kufizuar shkarkimet kombëtare të ndotësve acidifikues dhe eutrofikues dhe prekursorëve të ozonit.

3. Masat e referuara në pikën 2 të këtij neni kufizojnë tavanet kombëtare vjetore të atyre substancave dhe, në veçanti, të dioksidit të squfurit, oksideve të azotit, përbërjeve të paqëndrueshme organike dhe amoniakut, në sasi jo më të mëdha se tavanet e shkarkimeve të miratuara për secilën nga këto substanca.

4. Kur është e nevojshme, leja përkatëse e mjedisit, sipas përcaktimit të nenit 29 të këtij ligji, përmban kushtet që sigurojnë respektimin e tavaneve kombëtare të shkarkimeve.

5. Tavanet kombëtare të shkarkimeve dhe masat e referuara në pikën 2 të këtij neni, për mbrojtjen e efektshme të njerëzve nga rreziqet e njohura në shëndet nga ndotja e ajrit, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 32

Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të ndotësve

1. Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve përmban informacionin për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve dhe të mbetjeve, vlerësimin e prirjeve të tyre, monitorimin e progresit të bërë përmes politikave e programeve mjedisore, të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe mundëson të drejtën e publikut për t'iu dhënë ky informacion.

2. Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve administrohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

3. Operatori i veprimtarive, të cilave u referohet ky nen, mban, përditëson dhe i raporton çdo vit Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e këtij neni.

4. Kërkesat e hollësishme për funksionimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, lista e veprimtarive dhe ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe formulari i deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe transferimin e ndotësve nga operatori miratohen nga Këshilli i Ministrave.

SEKSIONI 3

MASA TË TJERA TË KONTROLLIT TË NDOTJES

Neni 33

Menaxhimi i integruar i mbetjeve

1. Menaxhimi i integruar i mbetjeve synon parandalimin ose reduktimin e mbetjeve dhe ndikimeve të dëmshme të tyre mbi mjedisin, si dhe përdorimin e efektshëm të burimeve natyrore, me qëllim mbrojtjen e mjedisit, të burimeve, të shëndetit të njeriut, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

2. Masat për menaxhimin e mbetjeve përcaktohen me ligj të posaçëm.

Neni 34

Kimikatat

1. Mbrojtja nga efektet e dëmshme të kimikateve, përbërjeve dhe preparateve të tyre përfshin masat dhe procedurat e mbrojtjes nga efektet e tyre të dëmshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
2. Masat për zbatimin e mbrojtjes nga efektet e dëmshme të kimikateve përcaktohen me ligj të posaçëm.

Neni 35

Substancat ozonholluese

1. Rregullat për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve, që përmbajnë këto substanca, miratohen nga Këshilli i Ministrave.
2. Veprimtaritë e lidhura me substancat ozonholluese licencohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshihen në kategorinë III. 3 të shtojcës së tij.

Neni 36

Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht

1. Ndalohet shkarkimi i qëllimshëm në mjedis apo hedhja në treg e Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht, që mund të shkaktojnë efekte të dëmshme mbi mjedisin dhe shëndetin e njeriut, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi, në përputhje me parimin e parandalimit dhe masave paraprake.
2. Ky nen nuk zbatohet për ushqimet dhe ushqimin për kafshë, që përmbajnë Organizma të Modifikuar Gjenetikisht, të cilat rregullohen me ligj të posaçëm.
3. Rregullat e hollësishme për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht, për qëllime të tjera, përveç hedhjes së tyre në treg, si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 37

Ndotësit organikë të qëndrueshëm

1. Ndalohen prodhimi, importi, hedhja në treg dhe përdorimi i kimikateve dhe pesticideve, që shfaqin karakteristika të ndotësve organikë të qëndrueshëm, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga legjislacioni në fuqi.

2. Lista e substancave, të referuara në pikën 1 të këtij neni, kontrolli i prodhimit, importit, hedhjes në treg dhe përdorimit, përjashtimet nga masat e kontrollit dhe reduktimi, minimizimi e eliminimi i shkarkimit të këtyre substancave miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 38

Mbrojtja nga zhurmat dhe dridhjet

1. Mbrojtja nga zhurmat dhe dridhjet përfshin masat e mbrojtjes nga zhurmat dhe dridhjet, ndaj të cilave njerëzit janë të ekspozuar, në veçanti në zona të banuara, në parqe publike apo në zona të tjera të qeta në zona urbane, në zona të qeta në zona rurale, pranë shkollave, spitaleve, si dhe pranë ndërtesave e zonave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmave dhe/ose dridhjeve.

2. Masat për zbatimin e mbrojtjes nga zhurmat dhe dridhjet përcaktohen me ligj të posaçëm.

Neni 39

Erërat e pakëndshme

1. Mbrojtja nga erërat e pakëndshme përfshin masat mbrojtëse ndaj shkarkimit të substancave me erë të pakëndshme ose potencialisht të pakëndshme nga veprimtaritë që i gjenerojnë ato dhe ndaj të cilave ekspozohen njerëz.

2. Masat për mbrojtjen ndaj erërave të pakëndshme dhe kriteret e vlerësimit për veprimtaritë e reja dhe ekzistuese me shkarkime me erë të pakëndshme ose potencialisht të pakëndshme apo për burimet e këtyre erërave miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 40

Mbrojtja nga rrezatimi

1. Mbrojtja nga rrezatimi jonizues dhe jojonizues synon parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e rrezikut ndaj jetës dhe shëndetit të njeriut, si dhe ndaj mjedisit.

2. Masat për mbrojtjen nga rrezatimin jonizues dhe jojonizues përcaktohen me ligj të posaçëm.

KREU VI

MONITORIMI I GJENDJES SË MJEDISIT

SEKSIONI 1

GJENDJA E MJEDISIT

Neni 41

Monitorimi i gjendjes së mjedisit

1. Monitorimi i gjendjes së mjedisit është vëzhgimi dhe regjistrimi, sipas një plani dhe rregulli të caktuar, i cilësisë së mjedisit dhe i ndryshimeve të gjendjes së përbërësve të tij. Në veçanti, ai përfshin:

- a) cilësinë e ujërave sipërfaqësore;
- b) cilësinë e ujërave nëntokësore;
- c) cilësinë e ajrit; ç) mbetjet;
- d) zhurmat; dh) rrezatimet;
- e) cilësinë e tokës;
- ë) florën, faunën, biodiversitetin, pyjet;
- f) ndikimet e sektorëve ekonomikë mbi përbërësit e mjedisit;
- g) monitorimin e fenomeneve natyrore dhe ndikimin e mundshëm të tyre mbi mjedisin;
- gj) monitorimin e ndikimeve të ndotjes së mjedisit mbi shëndetin e njeriut.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat dhe procedurat për hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit.

Neni 42

Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit

1. Në zbatim të nenit 41 të këtij ligji, ngrihet Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit, i cili shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Gjendjes së Mjedisit.

2. Organizimi dhe funksionimi i rrjetit dhe mënyra, procedura dhe forma e paraqitjes së të dhënave në këtë rrjet miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 43

Kufizimi i pronësisë dhe i të drejtave të tjera reale për monitorimin e mjedisit

1. Çdo personi fizik apo juridik, subjekti privat ose publik, i kufizohet e drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi pronën në atë pjesë të saj, ku vendosen objekte dhe/ose aparatura matëse për kryerjen e monitorimit të mjedisit në rastet kur mendohet që kryerja e monitorimit të mjedisit është në interes të publikut, në përputhje me sa parashikohet në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik".

2. Me qëllim kryerjen e monitorimit të mjedisit, personi i autorizuar përdor kryesisht tokën në pronësi të shtetit, atje ku ndërhyrja për përdorimin aktual të asaj pjese toke është minimale. Gjatë kryerjes së veprimtarive që kanë të bëjnë me instalimin e një objekti/impianti, të tilla si aparatet dhe pajisjet matëse, të referuara në pikën 1 të këtij neni, personi i autorizuar minimizon ndërhyrjen për përdorimin e asaj pjese toke sa më shumë të jetë e mundur dhe pas kryerjes së veprimtarisë e rikthen tokën në gjendjen e saj të mëparshme.

SEKSIONI 2

MONITORIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Neni 44

Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë

1. Operatori i veprimtarive, të përfshira në kategoritë A, B dhe C, të referuara në nenin 29 të këtij ligji, monitoron shkarkimet e veprimtarisë së tij, në përputhje me dispozitat e legjislacionit për lejet e mjedisit dhe kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit.
2. Operatori i referuar në pikën 1 të këtij neni monitoron burimet e shkarkimit të veprimtarisë së vet dhe kryen monitorime të tjera, duke përdorur pajisje dhe instrumente të miratuara, përmes procedurës për verifikimin e matjeve, të parashikuara në legjislacionin e posaçëm dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit, si dhe mban këto pajisje e instrumente në një gjendje të përshtatshme pune.
3. Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar.
4. Rezultatet e vetëmonitorimit u jepen autoriteteve përkatëse në përputhje me legjislacionin për lejet mjedisore dhe me kushtet e përfshira në lejen përkatëse mjedisore.

KREU VII

INFORMACIONI MJEDISOR

Neni 45

Qëllimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit mjedisor

1. Sistemi i informacionit mjedisor i shërben mbrojtjes dhe menaxhimit të integruar të mjedisit dhe përbërësve të tij, monitorimit të zbatimit të politikave mjedisore, raportimeve të ndërsjella, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe sigurimit të informimit të publikut.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit administron sistemin e informacionit mjedisor.

3. Autoritetet publike bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, me qëllim sigurimin e funksionimit të duhur të këtij sistemi. Mjetet, metodologjia dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit, në lidhje me funksionimin e këtij sistemi, miratohen nga Këshilli i Ministrave.

4. Sistemi i informacionit mjedisor përmban të dhëna për gjendjen e mjedisit, ngarkesën ndotëse dhe ndikimet në mjedis, reagimin e publikut dhe, veçanërisht, të dhëna për:

a) gjendjen e përbërësve të mjedisit, të mbledhura dhe të përpunuara në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera të posaçme;

b) shkarkimet e ndotësve në mjedis, të përfuara nga Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;

c) karakteristikat natyrore dhe fizike të përbërësve të mjedisit dhe fenomenet natyrore që kanë ndikim mbi to;

ç) mjedisin dhe përbërësit e tij, të përfuara nga projekte dhe programe kërkimore dhe vlerësuese;

d) burimet natyrore dhe përdorimin e tyre;

dh) zonat e përcaktuara si të mbrojtura apo të rrezikuara, në bazë të akteve normative të posaçme apo konventave ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

e) biodiversitetin dhe përbërësit e tij;

ë) efektet e ndotjes në mjedis dhe shëndetin e njeriut;

f) mbetjet dhe menaxhimin e ndotjeve;

g) substancat e rrezikshme;

gj) aksidentet industriale dhe ekologjike;

h) masat e sigurisë dhe masat që duhen marrë në rast aksidentesh;

i) ndotësit e mjedisit;

j) masat e politikave mjedisore, planet dhe programet e mbrojtjes së mjedisit;

k) veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit;

l) lejet e lëshuara për kryerjen e veprimtarive ndotëse dhe përmbajtjen e tyre.

Neni 46

Informimi i publikut në lidhje me çështjet mjedisore

1. Informacioni mjedisor përfshin çdo informacion të paraqitur në formë audioje, vizuale, elektronike, me shkrim ose në ndonjë mënyrë tjetër në lidhje me:

a) gjendjen e përbërësve të mjedisit, të tillë si: ajri dhe atmosfera, uji, toka, peizazhi dhe zonat natyrore, përfshirë ligatinat, zonat bregdetare e detare, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tij, përfshirë Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht, dhe ndërveprimin ndërmjet tyre;

b) faktorë të tillë, si substancat, energjia, zhurmat, rrezatimi, vibracionet, erërat e pakëndshme apo mbetjet, përfshirë mbetjet radioaktive, shkarkimet në ajër dhe ujë, si dhe shkarkime të tjera në mjedis, të cilat kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit e mjedisit, të referuar në shkronjën "a" të kësaj pike;

c) masa të tilla, si politikat, legjislacioni, planet, programet, marrëveshjet mjedisore, si dhe veprimtaritë që kanë ose mund të kenë ndikim mbi përbërësit dhe faktorët e referuar në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, si dhe masat apo veprimtaritë e përcaktuara për të mbrojtur këta përbërës;

ç) raportet në lidhje me zbatimin e legjislacionit mjedisor;

d) analizat kosto-përfitime dhe analiza të tjera ekonomike, si dhe parashikimet e përdorura brenda kuadrit të masave dhe veprimtarive, të referuara në shkronjën "c" të kësaj pike;

dh) gjendjen dhe sigurinë e shëndetit të njeriut, përfshirë ndotjen e zinxhirit ushqimor, atje ku është e nevojshme, kushtet e jetesës, objektet me vlera kulturore dhe arkeologjike, si dhe strukturat e ndërtuara, për sa kohë që ato ndikohen apo mund të ndikohen nga gjendja e përbërësve të mjedisit, të referuar në shkronjën "a" të kësaj pike, ose nga ndikimi në ato përbërës të secilës prej çështjeve të referuara në shkronjat "b" dhe "c" të kësaj pike.

2. Autoritetet publike përkatëse, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare", i sigurojnë publikut mundësinë për të marrë informacionin mjedisor që ato disponojnë.

Neni 47

E drejta për të pasur informacion mjedisor

1. Çdo personi fizik dhe juridik i sigurohet informacioni i disponueshëm për mjedisin, pa qenë nevoja të shfaqë një interes specifik për të.

2. Procedurat dhe kërkesat e tjera të hollësishme për zbatimin e këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 48

E drejta për padi gjyqësore

Në rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjeje dhe dëmtimi të tij, publiku ka të drejtë:

a) t'u kërkojë autoriteteve publike përkatëse marrjen e masave të duhura brenda afateve dhe në përputhje me autoritetin që u jep ligji;

b) të ngrejë padi në gjykatë, në përputhje me kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kundër autoritetit publik ose personit fizik e juridik, që ka sjellë dëme në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë.

Neni 49

Pjesëmarrja e publikut dhe publiku i përfshirë në vendimmarrje

E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së autoriteteve publike për mjedisin përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

KREU VIII

PËRGJEGJËSIA MJEDISORE

Neni 50

Përgjegjësia për dëmin në mjedis

1. Qëllimi i përgjegjësisë për dëmin në mjedis, mbështetur në parimin "Ndotësi paguan", është:

a) parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit;

b) rehabilitimi i mjedisit;

c) prezantimi i masave dhe i praktikave për minimizimin e rrezikut të dëmtimit të mjedisit.

2. Përgjegjësia për dëmin në mjedis përcaktohet në bazë të:

a) dëmit të shkaktuar në mjedis nga çdonjëra prej veprimtarive të rrezikshme, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, të parashikuara në shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni, si dhe nga kërcënimi i mundshëm për një dëm të tillë;

b) dëmi i shkaktuar ndaj llojeve të mbrojtura dhe habitateve natyrore nga çdo veprimtari profesionale e ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni, si edhe nga çdo kërcënim i mundshëm i këtij dëmi, si pasojë e kryerjes së këtyre veprimtarive, për shkak të pakujdesisë së operatorit.

3. Këshilli i Ministrave miraton:

a) listën e veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin, në kuptim të pikës 2 të këtij neni;

b) kriteret, në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis.

4. Ministri miraton:

a) masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar;

b) metodën për specifikimin e shpenzimeve për përcaktimin dhe eliminimin e kërcënimit dhe të dëmit.

5. Operatori, që kryen veprimtaritë e parashikuara në shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni, i cili ka shkaktuar një dëm apo paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë për dëme në mjedis, është përgjegjës për këtë dëm.

6. Operatori është përgjegjës nëse:

a) nuk merr masat e nevojshme parandaluese;

b) nuk merr masat e nevojshme zhdëmtuese;

c) nuk njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për rrezikun e dëmit në mjedis, i cili mund të ishte shkaktuar, pavarësisht nga masat e marra apo se dëmi mund të ketë ndodhur ose jo.

7. Në rast se dëmi në mjedis nuk ka ndodhur, por ekziston një kërcënim i drejtpërdrejtë për një dëm të tillë, operatori merr menjëherë dhe pa vonesë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit në mjedis. Nëse operatori nuk e përmbush këtë detyrim, Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr masat e nevojshme parandaluese dhe operatori është përgjegjës për të mbuluar koston përkatëse.

8. Në rast se, pavarësisht nga masat e referuara në pikën 6 të këtij neni, operatori nuk arrin të eliminojë kërcënimin e drejtpërdrejtë të dëmit në mjedis, ai njofton menjëherë dhe pa vonesë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, e cila:

a) i kërkon operatorit të sigurojë informacion për çdo kërcënim për dëmet në mjedis ose për rastet kur dyshohet për ekzistencën e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për dëme në mjedis;

b) i kërkon operatorit të marrë masat e nevojshme dhe i jep atij udhëzime për masat parandaluese;

c) merr masat e nevojshme parandaluese apo cakton një subjekt tjetër, fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, me shpenzimet e operatorit.

9. Në rast se dëmi në mjedis ka ndodhur, operatori:

a) informon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për dëmin e shkaktuar;

b) kryen rehabilitimin e të gjithë dëmit, në përputhje me parimin "Ndotësi paguan";

c) merr të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin në mjedis, me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme në mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore;

ç) merr të gjitha masat e parashikuara në shkronjën "a" të pikës 4 të këtij neni.

10. Në rast se disa operatorë kryejnë një nga veprimtaritë e referuara në shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni, brenda të njëjtit territor, ata mbajnë bashkërisht dhe reciprokisht përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga kryerja e asaj veprimtarie, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

11. Në rast se dëmi në mjedis ka ndodhur, Agjencia Kombëtare e Mjedisit:

a) i kërkon operatorit të sigurojë informacion të mëtejshëm për dëmin e shkaktuar;

b) merr, i kërkon apo i jep udhëzime operatorit për të marrë të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin në mjedis, me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme në mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore;

c) i kërkon operatorit të marrë masat e nevojshme rehabilituese, si dhe i siguron atij udhëzimet e duhura për masat rehabilituese që duhet të merren;

ç) merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, me shpenzimet e operatorit, në rast se operatori nuk e ka përmbushur këtë detyrim;

d) merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik, për të

marrë masat e duhura, në rast se operatori nuk mund të identifikohet, apo nuk i kërkohet të përballojë

shpenzimet, siç parashikohet në pikat 2 e 3 të nenit 54 të këtij ligji.

12. Agjencia Kombëtare e Mjedisit specifikon masat rehabilituese për sa i përket dëmit të shkaktuar në mjedis.

13. Në rastin e një dëmi të shkaktuar në mjedis, operatori përcakton dhe propozon masat e nevojshme rehabilituese, siç parashikohet në shkronjën "a" të pikës 4 të këtij neni, dhe ia paraqet ato Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për miratim. Gjatë përcaktimit të masave rehabilituese, operatori merr parasysh që këto masa të jenë të përshtatshme dhe efikase për eliminimin e të gjithë dëmit që i është shkaktuar mjedisit.

14. Në rast se dëmi i shkaktuar në mjedis është i tillë që masat rehabilituese nuk mund të merren njëherazi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton masat parësore dhe me kosto më të ulët që do të ndërmerren. Në përcaktimin e masave parësore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr parasysh natyrën, shkallën dhe rëndësinë e secilit prej dëmeve të shkaktuara në mjedis, rrezikun ndaj shëndetit të njeriut, si edhe aftësinë e rehabilitimit natyror të mjedisit.

15. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për identifikimin e operatorit që paraqet kërcënimin e drejtpërdrejtë për një dëm të mundshëm apo që ka shkaktuar dëmin në mjedis, për vlerësimin e rëndësisë së dëmit të shkaktuar, si dhe për përcaktimin e masave rehabilituese.

Neni 51

Shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese

1. Operatori mbulon shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese për dëmin që ai ka shkaktuar në mjedis.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, operatori nuk bën kompensimin e shpenzimeve për marrjen e masave parandaluese e rehabilituese për dëmin e shkaktuar në mjedis, në rast se ai vërteton që dëmi i shkaktuar apo kërcënimi për shkaktimin e një dëmi në mjedis:

a) është pasojë e një fenomeni natyror të paparashikueshëm dhe të pashmangshëm, i cili nuk mund të parandalohej apo të eliminohej;

b) është shkaktuar nga një palë e tretë dhe/ose ka ndodhur pavarësisht nga marrja e masave të duhura;

c) është pasojë e zbatimit të një vendimi të detyrueshëm, të lëshuar nga një autoritet publik.

3. Operatori nuk është i detyruar të kompensojë shpenzimet për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese, në rast se vërtetohet që dëmi në mjedis nuk është shkaktuar për faj të tij, por është shkaktuar nga:

a) një shkarkim apo veprimtari tjetër e autorizuar apo në përputhje me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit;

b) një shkarkim, veprim, apo një produkt i përdorur a i prodhuar nga veprimtaria, potenciali dëmtues i të cilit në momentin e shkakimit të dëmit, ishte i panjohur nga shkenca.

Neni 52

Kompensimi i dëmit në mjedis

1. Subjektet fizike apo juridike dhe shoqatat mjedisore në territorin, që preket drejtpërdrejt apo vuan pasojat e dëmit të shkaktuar në mjedis, kanë të drejtë t'i kërkojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të kërkojë nga operatori:

a) rikthimin e mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme;

b) kompensimin e dëmit të shkaktuar në mjedis, në përputhje me sa parashikohet në këtë ligj, nëse rikthimi i mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme është i pamundur.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlerëson se rehabilitimi dhe kthimi i mjedisit në gjendjen që kishte para se të shkaktohej dëmi është i pamundur, detyron operatorin të paguajë kompensimin për dëmin e shkaktuar në mjedis.

Neni 53

Detyrimi për të vënë paraprakisht në dispozicion fonde për kompensimin e dëmit

1. Operatori, që kryen cilëndo nga veprimtaritë e përmendura në listën e referuar në shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 50 të këtij ligji, vë, paraprakisht, në dispozicion fondet e nevojshme për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis.

2. Këshilli i Ministrave miraton metodat dhe procedurat për sigurimin e fondeve të tilla, si garancitë apo siguracionet e nevojshme.

Neni 54

Burime të tjera për mbulimin e shpenzimeve për masat rehabilituese

1. Buxheti i Shtetit siguron burimet për rehabilitimin e dëmit, pasojat e të cilit duhen eliminuar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në shkronjën "a" të pikës 4 të nenit 50 të këtij ligji, kur identifikimi i operatorit është i pamundur.

2. Buxheti i Shtetit siguron fondet financiare për korrigjimin e një dëmi shumë të madh në mjedis, që është shkaktuar nga një veprimtari që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur operatori i referuar në pikat 1 e 2 të këtij neni identifikohet më pas, i kërkon atij rimbursimin e shpenzimeve të bëra për eliminimin e pasojave të dëmit në mjedis brenda një periudhe prej pesë vitesh nga identifikimi i këtij të fundit.

KREU IX

INSTRUMENTET DHE MJETET E POLITIKËS SË MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 55

Ekoetiketa

1. Ministria i jep ekoetiketën, si një shenjë dalluese dhe njohjeje, personave fizikë dhe juridikë, që prodhojnë apo shpërndajnë produkte, të cilat, në krahasim me produktet apo shërbimet e barasvlershme, gjatë ciklit të jetës së tyre kanë ndikim më pak negativ dhe sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje të mjedisit, si dhe përdorim me efektshmëri më të lartë të përbërësve të tij. Produkte të tilla, si ato ushqimore, pijet, produktet farmaceutike dhe pajisjet mjekësore profesionale apo shërbime të lidhura me to nuk janë objekt i këtij neni.

2. Vlerësimi i efekteve më pak negative, të referuara në pikën 1 të këtij neni, ka të bëjë me përdorimin racional të burimeve natyrore dhe të energjisë, reduktimin e shkarkimeve në mjedis, përdorimin e mbetjeve që kanë vlerë apo me metoda të tjera, që bëjnë të mundur shfrytëzimin e mbetjeve para asgjësimit të tyre në fushën përkatëse (landfill) dhe marrjen e masave të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

3. Prodhuesi, importuesi, shpërndarë si i një prodhimi apo shërbimi mund të kërkojë të pajiset me ekoetiketën, e cila duhet të përmbajë bashkëlidhur të gjitha dokumentet dhe provat që produkti në fjalë i përmbush kërkesat e përcaktuara.

4. Ministria mund ta heqë ekoetiketën e dhënë kur personi i referuar në pikën 3 të këtij neni nuk vepron në pajtim me kërkesat, në bazë të të cilave është dhënë etiketa, ose nuk i përmbush më kërkesat e përcaktuara për pajisjen me etiketë.

5. Ministria promovon përdorimin e produkteve dhe shërbimeve, që kanë ekoetiketën, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit të konsumatorëve, prodhuesve, tregtuesve dhe publikut.

6. Këshilli i Ministrave miraton procedurën dhe kërkesat për pajisjen me ekoetiketën, mënyrën e dhënies, përdorimit dhe vlefshmërisë së saj, përbërjen dhe funksionimin e komisionit për lëshimin e ekoetiketave, pjesëmarrjen e individëve, shoqatave dhe të autoriteteve publike në procedurën e dhënies së ekoetiketës, të referuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 56

Skema e ekomenaxhimit dhe auditimit

1. Ministria nxit përdorimin e skemës së ekomenaxhimit dhe auditimit dhe pjesëmarrjen vullnetare të organizatave, me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e performancës mjedisore të tyre dhe të palëve të tjera të interesuara.

2. Këshilli i Ministrave miraton procedurat dhe kërkesat për dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit.

Neni 57

Marrëveshjet vullnetare

1. Organizata dhe grupe, që përfaqësojnë interesa të caktuar, grupe operatorësh ose operatorë individualë, mund të lidhin marrëveshje vullnetare me autoritetet përkatëse, në mënyrë që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor.

2. Procedurat dhe kërkesat e tjera të hollësishme për zbatimin e këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.

3. Secila prej këtyre marrëveshjeve vullnetare është e detyrueshme nga çasti i nënshkrimit dhe mospërmbushja e kushteve të caktuara në të konsiderohet si një shkelje e kontratës.

Neni 58

Edukimi dhe trajnimi për mbrojtjen e mjedisit

1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe për formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë, nxitin, mbështetin dhe organizojnë edukimin dhe trajnimin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përmes sistemit arsimor, kërkimit shkencor, formave të të mësuarit, të të formuarit dhe të trajnimit gjatë gjithë jetës.
2. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe për formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë, formulojnë udhëzimet e duhura për një program mësimor dhe edukativ, në përputhje me përparësitë dhe objektivat e programeve strategjike kombëtare e ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

KREU X

ORGANET SHTETËRORE PËR MJEDISIN

SEKSIONI 1

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Neni 59

Organizimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj.
4. Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.
5. Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit.

Neni 60

Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione:

a) hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit;

c) kryerjen e shërbimeve të matjes së shkarkimeve në mjedis me kërkesë të ministrisë; ç) këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;

d) krijimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor;

dh) krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;

e) sigurimin e informacionit mjedisor për publikun, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ë) sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

f) sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

g) menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet.

2. Kjo agjenci kryen edhe funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm.

Neni 61

Nëpunësit dhe punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil, të parashikuara për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet ndryshe në këtë ligj. Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është "epriori i drejtpërdrejtë", në përputhje me këto dispozita. Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

SEKSIONI 2

INSPEKTIMI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 62

Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit

1. Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, kryhet nga inspektorati shtetëror kompetent (më poshtë "Inspektorati"), që ka këto funksione:

- a) siguron kontrollin shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;
- b) siguron përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për lejet e mjedisit;
- c) përgatit programet vjetore të inspektimit dhe për sigurimin e zbatimit të tyre;
- ç) siguron informimin për publikun për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- d) siguron informimin për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- dh) siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- e) kryen kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur. Inspektori I mjedisit mund të kryejë edhe detyra të tjera, të përcaktuara në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit;
- ë) çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

2. Inspektimi për zbatimin e këtij ligji, për sa i përket tregtimit të produkteve, lëndëve të para, substancave kimike dhe paketimit të kimikateve, si dhe etiketimit të produkteve dhe informacionit që përmban paketimi, lidhur me ndikimet në mjedis, kryhet nga strukturat inspektuese përkatëse, sipas legjislacionit të posaçëm.

Neni 63

Fusha e inspektimit

Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit përfshin:

- a) kontrollin dhe nxitjen e përputhjes së veprimtarive me kërkesat e legjislacionit përkatës;
- b) monitorimin e ndikimit të veprimtarive mbi mjedisin për të përcaktuar nëse kërkohen veprime të mëtejshme, duke përfshirë shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit, për të siguruar përputhjen me legjislacionin përkatës;
- c) kontrollin e përmbushjes të standardeve të cilësisë së mjedisit;

- ç) verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë;
- d) kontrollin dhe promovimin e përputhjes me kërkesat e lejes përkatëse të mjedisit;
- dh) verifikimin dhe vlerësimin e monitorimit të përputhjes së bërë nga operatori i veprimtarisë;
- e) vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë;
- ë) kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve përkatëse, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e tyre;
- f) kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë;
- g) kontrollin e dokumenteve të mbajtura nga operatori i veprimtarisë;
- gj) kontrollin dhe nxitjen e përputhshmërisë me marrëveshjet vullnetare.

Neni 64

Detyrimi për të siguruar përputhshmërinë

1. Inspektorati ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që, në bazë të këtij ligji, mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit.
2. Inspektorati ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që, në bazë të këtij ligji, mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në dispozitat e legjislacionit për ndërtimet, për veprimtaritë e planifikuara, për të cilat nevojitet kryerja e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Neni 65

Njoftimet për përputhshmërinë

1. Inspektorati, në rast se vlerëson se operatori ka shkelur, po shkel apo ka gjasa të shkelë kushtet e lejes përkatëse të mjedisit, i dërgon atij njoftimin për përputhshmërinë, një kopje e të cilit i dërgohet autoritetit publik, që ka dhënë lejen për ushtrimin e veprimtarisë
2. Njoftimi për përputhshmërinë bëhet me shkrim dhe:
 - a) përshkruan çështjet që përbëjnë shkelje apo ato që tregojnë se ka gjasa që të ndodhë shkelja;
 - b) përshkruan hapat që merren nga operatori për të korrigjuar shkeljen apo për të korrigjuar çështjet që tregojnë se ka gjasa që të ndodhë shkelja;
 - c) përcakton periudhën kohore kur merren këta hapa.

3. Njoftimi për përputhshmërinë mund të përfshijë hapat që merren për të përmbushur kushtet e lejes përkatëse të mjedisit gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të veprimtarisë, si dhe hapat për korrigjimin e efekteve të ndotjes së shkaktuar nga shkelja.

Neni 66

Njoftimet për pezullimin

1. Inspektorati, në rast se është i mendimit që ndërtimi apo kryerja e një veprimtarie ose ndërtimi, apo kryerja e saj në një mënyrë të caktuar përbën rrezik të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit, ai i dërgon njoftimin për pezullimin e asaj veprimtarie pronarit të sendit apo operatorit të veprimtarisë, sipas rastit. Një kopje e njoftimit për pezullim i dërgohet autoritetit publik, që ka dhënë lejen për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Njoftimi për pezullimin bëhet me shkrim dhe në të:

a) përcaktohet rreziku i mundshëm që ka lidhje me ndërtimin apo kryerjen e veprimtarisë;

b) përcaktohen hapat që merren për ta shmangur atë rrezik;

c) përcaktohet periudha kohore kur merren këta hapa;

ç) deklarohet që leja përkatëse e mjedisit apo pjesë të veçanta të saj nuk janë më të vlefshme, derisa të hiqet ky njoftim.

3. Leja përkatëse e mjedisit nuk është më, plotësisht apo pjesërisht, e vlefshme, siç është përcaktuar në njoftimin për pezullimin, në çastin që pronari i sendit apo operatori e ka marrë këtë njoftim.

4. Inspektorati mund ta revokojë njoftimin për pezullimin në çdo kohë në rast se ai vlerëson që janë marrë hapat e kërkuar nga ky njoftim për shmangien e rrezikut të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit.

SEKSIONI 3

DISPOZITA TË TJERA INSTITUCIONALE

Neni 67

Fondi i mjedisit

1. Për të mbështetur dhe për të nxitur veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit krijohet Fondi i Mjedisit.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për burimin e të ardhurave, mënyrën e funksionimit dhe të përdorimit të Fondit të Mjedisit.

Neni 68

Licencimi i veprimtarive me ndikim në mjedis

Veprimtaritë me ndikim në mjedis, të përcaktuara në këtë ligj, licencohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshihen në fushën III të shtojcës së tij.

KREU XI

KUNDËRVAJTJET

Neni 69

Kundërvajtjet

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) mosdhënia e informacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve nga operatori, sipas përcaktimit të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

b) mospërbushja e kërkesave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve dhe të pajisjeve që përmbajnë këto substanca, sipas përcaktimit të nenit 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

c) mospërbushja e kërkesave për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të Organizmave të Modifikuar Gjenetiki, për qëllime të tjera, përveç hedhjes së tyre në treg si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, sipas përcaktimit të nenit 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

ç) mospërbushja e kërkesave për ndalimin e prodhimit, të importit, hedhjes në treg dhe të përdorimit, për reduktimin e shkarkimeve, minimizimin dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm, sipas përcaktimit të nenit 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

d) mospërbushja e kërkesave për shkarkimin e erërave të pakëndshme nga veprimtaritë e reja dhe ekzistuese, sipas përcaktimit të nenit 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

dh) mosplotësimi nga personi i autorizuar, që kryen monitorimin e mjedisit, sa më shumë të jetë e mundur, i kërkesave për minimizimin e ndërhyrjes mbi përdorimin e tokës dhe mosplotësimi, pas

kryerjes së veprimtarisë, sa më shumë të jetë e mundur, i kërkesave për rikthimin e tokës në gjendjen e saj të mëparshme, sipas përcaktimit të nenit 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonese, deri në plotësimin e detyrimit;

e) mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për mundësinë e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për një dëm të tillë nga operatori, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 50 të këtij ligji, si dhe mosmarrja e masave të nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit në mjedis, pavarësisht nga detyrimi i tij për marrjen e masave parandaluese të dëmit në mjedis, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 50 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

ë) mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori se me gjithë masat e marra në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 6 të nenit 50 të këtij ligji, kërcënimi i drejtpërdrejtë i dëmit në mjedis nuk është shmangur, sipas përcaktimit të bërë në pikën 7 të nenit 50 të këtij ligji, pavarësisht nga detyrimi i tij për të siguruar paraprakisht fondet për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis, sipas përcaktimit të nenit 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

f) mospërbushja e kërkesave të pikës 8 të nenit 50 të këtij ligji, nga operatori, pavarësisht nga detyrimi i tij për të rikthyer mjedisin në gjendjen e mëparshme, rehabilitimin e mjedisit, kompensimin e dëmit të shkaktuar apo për të marrë masa të tjera të përcaktuara në këtë ligj, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

g) përdorimi i ekoetiketës nga zotëruesi i saj edhe pas heqjes së saj nga ministria, sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 55 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

gj) mosplotësimi nga operatori i kërkesave të përcaktuara në njoftimin e përputhshmërisë, brenda afatit të përcaktuar në të, sipas përcaktimit të nenit 65 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonese, deri në korrigjimin e mospërputhjes;

h) mosplotësimi nga pronari i sendit apo operatori i veprimtarisë i kërkesave të përcaktuara në njoftimin e pezullimit, brenda afatit të përcaktuar në të, sipas përcaktimit të nenit 66 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonese, deri në plotësimin e detyrimit.

2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 69 të këtij ligji, e ka inspektorati. Inspektorati ka të drejtë të sekuestrojë pajisjen, me të cilën, sipas tij, është kryer kundërvajtja e parashikuar në këtë ligj.

3. Pavarësisht nga dënimi i parashikuar në shkronjat "k" dhe "l" të pikës 1 të këtij neni, ministri, me propozimin e inspektoratit, mund të pezullojë apo të revokojë lejen përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj dhe për këtë njofton Qendrën Kombëtare të Licencimit.

4. Në rastin e kundërvajtjeve serioze në këtë ligj, apo kur personi nuk ka paguar gjobën e vendosur sipas këtij ligji, inspektorati ka të drejtë të vërë nën sekuestrim pronën, me të cilën është kryer kundërvajtja.

5. Inspektorati mund të ndërmarrë sanksionet e parashikuara në këtë nen në çdo kohë, por jo më vonë se dy vite kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, sikurse parashikohet dhe në nenin 46 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

6. Inspektorati merr një vendim dhe e njofton atë brenda 60 ditëve nga njoftimi i procesverbalit të inspektimit.

7. Gjoha paguhet brenda periudhës së përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

8. Ministri, me propozimin e inspektoratit, në rastet kur gjoha nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, pezullon lejen përkatëse mjedisore deri në pagesën e gjobës.

9. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit apo revokimit të lejes së mjedisit, ka të drejtën e ankimit tek titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

11. Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e shmang subjektin përkatës nga detyrime të tjera të përcaktuara në këtë ligj, si dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU XII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 70

Propozimi i akteve nënligjore

1. Ministri propozon aktet nënligjore, që miratohen nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave dhe/apo ministri miratojnë aktet nënligjore, sipas përcaktimit dhe në zbatim të këtij ligji, brenda një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 71

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 21 pika 4, 26 pika 2, 27 pika 4, 31 pika 5, 32 pika 4, 35, 36 pika 3, 37 pika 2, 39 pika 2, 41 pika 2, 42 pika 2, 45 pika 3, 47

pika 2, 49 , 50 pika 3, 53 pika 2, 55 pika 6, 56 pika 2, 57 pika 2, 59 pika 4, 61 pika 1 dhe 67 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 50 pika 4 të këtij ligji.

Neni 72

Vazhdimi i efekteve juridike për aktet nënligjore

1. Vendimi nr.860, datë 20.12.2006, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë, të qëndrueshëm", miratuar në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 37 të këtij ligji.

2. Vendimi nr.847, datë 29.11.2007, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të mjedisit", miratuar në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 21 të këtij ligji.

3. Vendimi nr. 543, datë 23.6.2005, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese", miratuar në zbatim të nenit 17 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 35 të këtij ligji.

4. Vendimi nr.1189, datë 18.11.2009, i Këshillit të Ministrave "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit", miratuar në zbatim të nenit 53 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 41 të këtij ligji.

Neni 73

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim sa parashikohet në pikat 2 deri në 7 të këtij neni.

2. Pa rënë ndesh me nenin 24 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon Vlerësimit Strategjik Mjedisor deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

3. Pa rënë ndesh me nenin 25 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon vlerësimit të ndikimit në mjedis deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

4. Pa rënë ndesh me nenin 29 të këtij ligji, nenet 34, 36-46 dhe 51/1 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për lejen, autorizimin dhe pëlqimin mjedisor, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

5. Pa rënë ndesh me nenin 30 të këtij ligji, neni 49 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për parandalimin e aksidenteve industriale, vazhdon të ketë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tij me ligj të posaçëm.

6. Pa rënë ndesh me nenin 33 të këtij ligji, nenet 20-24 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për menaxhimin e mbetjeve, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

7. Pa rënë ndesh me nenin 34 të këtij ligji, nenet 20 dhe 23 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për importimin dhe transitin e lëndëve të rrezikshme, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

Neni 74

Dispozita kalimtare

Funksionet e dhëna nga ky ligj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe, në mënyrë të veçantë, ato të përcaktuara në nenin 60 të tij të kryhen nga ministria, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 75

Ky ligj hyn në fuqi 18 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7033, datë 29.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi